

Analiza e zhanreve letrare

Informatat themelore:	
Njësia akademike:	Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Filologjisë – Dega e Letërsisë Shqipe
Lënda:	Analiza e zhanreve letrare
Niveli:	Bachelor
Statusi:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti III - Semestri VI
Numri i orëve në javë:	2+1
Kreditë ECTS:	6 ECTS
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. dr. Nysret Krasniqi
Të dhënat kontaktuese:	nysret.krasniqi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<i>Analiza e zhanreve letrare</i> – është ndër lëndët kryesore në Programin e studimit të Letërsisë Shqipe të Fakultetit të Filologjisë. Qëllimi i saj është që t'i njoftojë studentët me transformimet zhanrore në kuadër të letërsisë së përgjithshme dhe të letërsisë shqipe. Nëpërmjet diskutimeve teorike dhe të shqyrtimeve konkrete të teksteve letrare do të kuptohen më qartë konvencat zhanrore dhe shpërndërrimet e tyre në poetikën letrare shqipe.

Qëllimet e lëndës:	Lënda <i>Analiza e zhanreve letrare</i> jua mundëson studentëve njohjen gjenerike të letërsisë dhe format e zhvillimit të saj zhanror - tipologjik. Përveç kësaj, nëpërmjet modeleve universale letrare dhe analizës së teksteve konkrete të letërsisë shqipe do të krijohet një njohje më specifike e evolucionit zhanror në korpusin e letërsisë shqipe.
--------------------	--

Rezultatet e pritshme të nxënies:	Të njohë historinë e zhvillimit të zhanreve letrare
	Të njohë dhe të diferencojë metodat dhe teoritë e studimit të zhanreve
	Të formulojë pikëpamjet individuale për zhvillimin e zhanreve letrare shqipe
	Të zhvillojë mendimin individual kritik-teorik për problemet e zhanrit letrar
	Të gjykojë për ligjësitë specifike zhanrore letrare

Ngarkesa e studentit

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime	1	15	15
Punë praktike			
Konsultime me mësuesin	1	15	15
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	2	15	30
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual	2	6	12
Përgatitja për provimin final	2	6	12
Koha e vlerësimit	2	6	12

Projektet, prezantimet, etj.		
Total		126:25=5.04 6 ECTS
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata, ushtrime, seminare dhe konsultime.	
Metodat e vlerësimit:	Vijueshmëria e studentit 20 %; Vlerësimi i parë: 30 %; Vlerësimi i dytë: 30 %; Seminari: 20 %	
Literatura primare:	Aristoteli: <i>Poetika</i> , Rilindja, Prishtinë, 1984 David Lodge: <i>Modern Criticism and Theory</i> , 2000 Derrida, Jacques, „The Law of the Genre,” <i>Acts of Literature</i> , ed. D. Attridge, New York, 1992 Eqrem Çabej: <i>Për gjenezën e literaturës shqipe</i> , 1938 Gerard Genette: <i>Figura III</i> , 2017 Nysret Krasniqi: <i>Letërsia e Kosovës 1953-2000</i> , 2016 Rene Welek & Austin Warren: <i>Teoria e letërsisë</i> , 2015 Rexhep M. Shala: <i>EX LIBRIS-moderna pashkiane</i> , 2000 Terry Eagleton: <i>Literary Theory</i> , 1995 Grup autorësh: <i>Teori dhe kritikë moderne</i> , 2008	
Literatura shtesë:	Rexhep M. Shala: <i>METATEZA- teoria dhe praksisi letrar</i> , Prishtinë, 2014 Kujtim M. Shala: <i>Shekulli i letërsisë shqipe</i> , 2006 Sabri Hamiti: <i>Poetika shqipe</i> , 2010 Osvald Dykro, Cvetan Todorov: <i>Fjalor enciklopedik i shkencave të ligjërimit</i> , 1984	

Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjërates
Java 1:	Zhanri letrar – koncepti dhe historia
Java 2:	Zhanret klasike letrare
Java 3:	Tragjedia, komedia, drama
Java 4:	Zhanret letrare shqipe
Java 5:	Analizë e zhanreve të poezisë shqipe
Java 6:	Analizë e zhanreve narrative shqipe

Java 7:	Vlerësimi i parë
Java 8:	Zhanret e romanit shqiptar
Java 9:	Zhanret e novelës dhe të tregimit shqiptar
Java 10:	Zhanret autobiografike
Java 11:	Ligjësitë e zhanreve letrare
Java 12:	Analiza e veprave teorike-analitike zhanrore
Java 13:	Studimet zhanrore shqipe
Java 14:	Vlerësimi i dytë
Java 15:	Diskutimi dhe dorëzimi i seminareve

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes:

Gjatë ligjëratave, ushtrimeve, diskutimeve në klasë duhet të dëshmohet përkushtim dhe pjesëmarrje aktive në procesin mësimor-shkencor.